



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:007179

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844541

C.nr. 1685/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.K nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, V.H nga Prizreni, A.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, B.R nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, dhe S.S nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson A.M avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson B.O avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8.491,75 euro, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkespadija e paditësve V.H, A.B, B.R dhe S.S.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.H, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 35% të pagës bazë (421.00 euro) x 35% (minusuar 46,66 euro në listën e pagave nga shuma 147,35 euro) = 100.69 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2.517,25 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.B, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,383,75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në

pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.R, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,383.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit S.S, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1.383,75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- VI. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.K.
- VII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.K, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 19% të pagës bazë (421.00 euro) x 19% (minusuar 41,04 euro në listën e pagave nga shuma 79.99 euro) = 38.95 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 973.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 29.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- VIII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit A.K, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1.815,75 euro e deri në shumën prej 973.75 euro dhe atë për shumën prej 842 euro.
- IX. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve: A.K, V.H, A.B, B.R dhe S.S, t'i paguajë shumën prej 332.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit A.K, V.H, A.B, B.R dhe S.S, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 29.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8.491,75 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në fshatin Opterushë, Komuna e Rahovecit. Paditësve sipas nenit 7 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, u takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 01.01.2021 e deri më 31.01.2023, ku në bazë të këtij padisë paditësve u takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit përkatësisht paditësit A.K, A.B, B.R dhe S.S me 27% ndërsa paditësit V.H me 35% të ardhurave në pagë të mësimdhënësve dhe atë mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare. Andaj i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 10.05.2024, ku ka theksuar se është fakt i pakontestueshëm se e paditura tashmë ka kryer detyrimin për pagesat në emër të stimulimit, në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Sa i përket Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 MASHTI ka shkëputur këtë kontratë me SBASHK. MASHTI me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshëm bazuar në kornizën ligjore në fuqi, pasi e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1733/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.K; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 63/3 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit V.H; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. Protokollit: 1734/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, paditësit A.B; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1747/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.R; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 58/3 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit S.S; listën e pagave për muajin shtator

2021 për paditësin A.K, listën e pagave për muajin shtator 2021 për paditësin V.H, listën e pagave për muajin shtator 2021 për paditësin A.B, listën e pagave për muajin shtator 2021 për paditësen B.R, listën e pagave për muajin shtator 2021 për paditësin S.S, diplomën Nr. 1746 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (Shkolla e Larte Pedagogjike-Gjakovë), e paditësit A.K; diplomën Nr. 290 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i i Edukimit Fizik dhe i Sportit, e paditësit V.H; diplomën Nr. 107 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.B; diplomën Nr. 91 e lëshuar nga , Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Edukimit, e paditëses B.B; diplomën Nr.336 e lëshuar nga , Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Edukimit, Qendra në Gjakovë, i paditësit S.S; licenca e mësimdhënësit nr.100009549 e paditësit A.K; licenca e mësimdhënëses nr.100009550 e paditësit V.H; licenca e mësimdhënësit nr.100009551 e paditësit A.B; licenca e mësimdhënësit nr.100009467 e paditëses B.R; licenca e mësimdhënësit nr.100009560 e paditësit S.S.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit posedojnë licenca. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe licencimit, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1733/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Lidhja e Prizrenit” në Apterushë.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 63/3 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit V.H, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Lidhja e Prizrenit” në Apterushë.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1734/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Lidhja e Prizrenit” në Apterushë.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 1747/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.R, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta

është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Lidhja e Prizrenit” në Apterushë.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 58/3 e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit S.S, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Lidhja e Prizrenit” në Apterushë.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.R ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.H ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.S ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e diplomës Nr. 1746 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (Shkolla e Lartë Pedagogjike-Gjakovë), e paditësit A.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K, ka përfunduar studimet më 28.07.2011 dhe mori titullin Arsimitar i Historisë-Gjeografisë.

Me administrimin e diplomës Nr.290 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Edukimit Fizik dhe i sportit në Prishtinë, e paditësit V.H, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.H ka përfunduar studimet më 04.01.2018 dhe mori titullin Master i Shkencave Sportive.

Me administrimin e diplomës Nr.107 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B ka përfunduar studimet më 11.04.2014 dhe mori titullin Bachelor i Matematikë-Informatikë.

Me administrimin e diplomës Nr. 91 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Prishtinë, e paditëses B.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.B ka përfunduar studimet më 14.06.2011 dhe mori titullin Baçelor i Programit Fillor.

Me administrimin e diplomës Nr.336 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, i paditësit S.S, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.S ka përfunduar studimet më 05.06.2015 dhe mori titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100009549, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100009550, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.H është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100009551, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100009467, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.R është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr.100009560, gjykata vërtetoi faktin se paditësi S.S është i licencuar nga MASHT-i”.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë e paditësve për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditësit V.H, në bazë të licencimit, për shkak se posedonë diplomë të nivelit Master i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 35%, paditësit A.B, B.R dhe S.S, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedojnë diplomë universitare i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27% ndërsa paditësi A.K në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedon diplomë të nivelit të Shkollës së Lartë Pedagogjike i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 19%.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve A.B, B.R dhe S.S i ka paguar shumën prej 58.32 euro, paditësit V.H, i ka paguar shumën prej 58.32 euro 46.66 euro, ndërsa paditësit A.K shumën prej 41.04 euro. Andaj, gjykata vendosi si në të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh “*Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune*” dhe paragrafi 4 “*Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA*”. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 842 euro për paditësin A.K, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 në pikën 4 nën-pikën 4 të vendimit përcaktohet se; ” *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%*”, në këtë drejtim paditësi A.K në kërkesëpadi ka kërkuar që të kompensohen për 27% të pagës bazë (421 euro), ndërsa bazuar në pikën 4 të Vendimit të Qeverisë, paditësi përfitojnë ngritje të bazë të pagës bazë prej 19% dhe jo 27% të pagës bazë siç pretendon paditësi.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore nuk është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 29.12.2023.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit V.H, A.B, B.R dhe S.S janë në marrëdhënie pune tek e paditura prandaj kërkesëpadinë e tyre e aprovoi tërësisht si të bazuar ndërsa kërkesëpadinë e paditësit A.K e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*”.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t'ia kompensojë të paditësve shumën si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1685/2023, më datë 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha-Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.